

## Legjionaret/ Januzi shenon per Vorskla

nga AlbaniaSoccer

E shtunë, 31 Gusht 2013 19:55

---



Ahmed Januzi, sulmuesi i kombetares shqiptare u be hero i skuadres Vorskla te Ukraines fale golit te tij te shenuar ne minuten e 25, te pjeses se pare. Ky gol i Januzit, ishte i dyti pas atij te Gromov i cili ka shenuar qe ne minute e dyte te fillimit te ndeshjes, cka beri te kuptohej qe ne pjesen e pare, se skuadra ne te cilen luan dhe mbrojtesi i kombetares Armend Dallku ishte me dominante kundrejt asaj te Hoverla ku aktivizohet edhe qendermbrojtesi Debatik Curri i cili ne perfundimin e pjeses se pare, u ndeshkua dhe me karton te verdhe dhe me pas u zevendesua nga trajneri. Pas perfundimit te pjeses se pare te ndeshjes ne minuten e 55, vendasit me gjithë perpjekjet arriten te shenonin nje gol,por prap nuk arriten te permbysin rezultatin. Autori i golit te dyte,shqiptari Januzi nuk i shpetoi gjykimit te gjyqtarit duke u ndeshkuar me karton te verdhe. Fale ketij rezultati sot,Vorskla renditet e 6-ta ne eliten e futbollit ukrainas dhe Januzi ngjitet në kuoten e dy golave.